



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 09

Prishtinë, më 12.12.2017, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S/1

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Glauk Konjufca, Sami Kurteshi, Arben Gashi, Korab Sejdiu, Igor Simiq, Shkumbin Demaliaj dhe Bilall Sherifi.

Mungoi: Agim Aliu.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Aferdita Fejzullahu-Kallzo.com; Gramoz Paçarada-KDI; Liridona Xhemajli-RTV/21; Shefki Kastrati-NDI; Anita Avdyli-Praktikante; Leutrim Latifi-Praktikant; Luljeta Krasniqi- OSBE; Bekim Kodraliu- OSBE; Pepa Laleva- EU-Projekt; Engjëllushe Januzi-EU- Projekt; Dibran Istrefi-Klan Kosova; Sanije Berisha- OSBE dhe Blerta Bejtullahu-EUSR.

Nga stafi i komisionit: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 17.10.2017, 24.10.2017, 01.11 dhe 08.11.2017;
3. Shqyrtimi i propozimit të Fakultetit Juridik për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
4. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Institucioneve/Agjencive që bien në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion;

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik;
6. Shqyrtimi në parim i Projekt-Kodit të Drejtësisë për të Mitur;
7. Shqyrtimi i kërkesës së Shoqatës së Mullisëve të Kosovës (SHMK);
8. Formimi i grupeve punuese për Projektligjin nr. 06/L-010 për Noterinë, Projektligjin nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-007 për procedurën jokontestimore, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/26 për Trashëgiminë në Kosovë dhe Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës;
9. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja-Propozoi që nga rendi i ditës të hiqet pika tre që ka të bëjë me propozimet e Fakultetit Juridik për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, sepse dosja nuk është e kompletuar edhe në gjuhën serbe.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të e mbajtura më 17.10.2017, 24.10.2017, 01.11 dhe 08.11.2017

Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi procesverbalet, nga mbledhjet e mbajtura më 17.10.2017, 24.10.2017, 01.11.2017 dhe 08.11.2017, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Institucioneve/Agjencive që bien në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion

Kryetarja tha se është bërë praktikë që jo vetëm Komisioni për Buxhet të shqyrtojë kërkesat buxhetore për institucionet e drejtësisë, por edhe Komisioni për Legjislacion gjithashtu ka organizuar dëgjim publik në lidhje me kërkesat buxhetore të institucioneve që bien në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion. Komisioni ka formuar një grup punues, ku janë shqyrtuar kërkesat buxhetore nga këto institucione, theksoi deputetja Albulena Haxhiu. Më pas fjalën ia kaloi deputetit Korab Sejdiu, si kryesues i grupit punues, që të arsyetojë rekomandimet e komisionit.

Korab Sejdiu tha se grupi punues ka trajtuar kërkesat që kanë ardhur nga agjencitë që bien në fushëveprim të komisionit, ku është vendosur që t'i rekomandohet Komisionit për Buxhet dhe Financa që në buxhetin e vitit 2018 të këtë parasysh rekomandimet e grupit punues. Më pas z. Sejdiu paraqiti para deputetëve të komisionit rekomandimin e grupit punues për ndarje të buxhetit si vijon:

1. Të ndahen mjete shtesë për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas, me kod organizativ 241 dhe me kod të programit (nën programit) 32600 në shumë totale 53,100 €, në kuadër

të kategorisë Paga dhe Mëditje 22,280 € për katër zyrtar të Agjencisë dhe në kuadër të kategorisë Mallra dhe Shërbime 30,820 €.

2. Të ndahen mjete shtesë për Akademinë e Drejtësisë, me kod organizativ 322, si dhe me kod të programit (nën programit) 91600. Në kuadër të kategorisë Mallra dhe Shërbime të ndahen mjete shtesë në shumë 301,740 €, për trajnime fillestare për prokurorë dhe gjyqtarë. Gjithashtu të ndahen mjete shtesë me shumë 8,820 në programin e njëjtë në kategorinë Mallra dhe Shërbime për mësimin në distancë. Po ashtu kërkojmë ndarjen e mjeteve shtesë për 7 pozita për burime njerëzore të Akademisë së Drejtësisë në kategorinë Paga dhe Mëditje me shumë 37,800 €.
3. Të ndahen mjete shtesë për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, me kod organizativ 329, si dhe me kod të programit (nën programit) 60600. Në kategorinë e Pagave dhe Mëditje me shumë 298,000 €, si dhe të rritet numri i punonjësve për 20 pozita pune. Nga shuma 298,000 €, 98,000 € do të përdoren për pagesë për pagat e 20 zyrtarëve, ndërsa 200,000 € do të përdoren për shtesa të zyrtarëve në emër të rrezikshmërisë. Të ndahen mjete shtesë me shumë prej 88,000 € në kategorinë e Investimeve Kapitale për blerjen e 3 veturave. Gjithashtu të ndahen mjete shtesë në kategorinë e shpenzimeve komunale me shumë 88,523 €.
4. Të ndahen mjete shtesë për Këshillin Prokurorial të Kosovës, me kod organizativ 250, si dhe me kod të programit (nën programit) 33500 prokurorët dhe administrata. Të rritet numri i punëtorëve për 148 pozita, si dhe buxheti në kategorinë Paga dhe Mëditje me shumë 1,098,218.82 €, si dhe në emër të shtesave kujdestarive në kategorinë Paga dhe Mëditje të ndahen mjete shtesë me shumë 578,861.30 € në programin e cekur më lart dhe të përkrahjet në tërësi kategoria ekonomike Mallra dhe Shërbime me shumë 1,014,000.00 €.
5. Të ndahen mjete shtesë për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, me kod organizativ 328, si dhe me kod të programit (nën programit) 33300 Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës me shumën totale 722,568.6, në këto kategori ekonomike: Në kuadër të kategorisë paga dhe mëditje me shumë 390,568.60 €, në kuadër të kategorisë Mallra dhe Shërbime shumë 82,000 €, në kuadër të kategorisë Subvencione dhe Transferim (kompensim të dënuarve pa bazë) me shumë 150,000 € dhe në kategorinë Shpenzime Kapitale 100,000 € për implementimin e projektit Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve.
6. Të ndahen mjete shtesë për Agjencinë Kundër Korrupsion, me kod organizativ 236 në kuadër të programit (nën programit) 20400 në shumën totale 83,000.00 €. Në kuadër të kategorisë Paga dhe Mëditje me shumë 53,000.00 € për 6 (gjashtë) zyrtarë dhe në kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime me shumë 30,000.00 €.

Albulena Haxhiu i njoftoi anëtarët e komisionit se me autorizim të komisionit iu është drejtuar Ministrisë së Administratës me një letër ku është kërkuar që këto dy institucione të vendosen në objekte publike në mënyrë që të mos paguajnë qira. Gjithashtu tha se ministria në përgjigjen që ka kthyer ka thënë se nuk ka objekte të lira për këto institucione, por është rekomanduar që të kërkohej buxhet për ndërtim të objekteve të reja. Sa i përket rekomandimit për Këshillin

Prokurorial ku janë kërkuar 148, ajo tha se sipas informatave që ka këto pozita janë përfshirë në buxhet, por kjo mbetet të verifikohet në vazhdim. Gjithashtu vërejtje kishte edhe për Agjencinë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, ku tha se me nënshkrimin e marrëveshjes për kopje të regjistrave kadastror shteti i Kosovës është zotuar që do të bëjë angazhim për ta jetësuar këtë marrëveshje, edhe pse VV e ka kundërshtuar sepse ka konsideruar që është e padrejtë që të mos e kemi origjinalin e librave kadastror, ndërsa tani në buxhet nuk janë përfshirë kërkesat buxhetore të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës kur dihet angazhimi i institucioneve për krijimin e kësaj agjencie, potenco i deputetja Albulena Haxhiu.

Sami Kurteshi- Paraqiti para anëtarëve të komisionit vërejtjet në lidhje me rekomandimin e Grupit Punues, me theks të veçantë për Këshillin Prokurorial të Kosovës, ku kërkohet kompletimi i kabinetit të kryeprokurorit të shtetit me pesë zyrtarë pa specifikuar pozitat për çka duhen këta zyrtarë, pastaj në pjesën ku kërkohen nëntë zëdhënës për prokurori të ndryshme ku tha se duke pasur parasysh punën e prokuroreve ku ishte dashur që një prokuror të ketë dy bashkëpunorë profesionalë. Mendoj se ky numër që është kërkuar është i vogël në krahasim me zyrtarët që janë kërkuar për kabinet të kryeprokurorit. Z. Kurteshi tha se vërejtje ka edhe për Këshillin Gjyqësor sepse në kërkesat që i kanë bërë nuk ka askund kërkesë për shtimin e bashkëpunorëve profesionalë. Meqenëse kemi buxhet të limituar për nga dy bashkëpunorë profesionalë, mendoj se nga një bashkëpunor profesional për secilin prokuror dhe gjykatës është i domosdoshëm në mënyrë që puna të bëhet më efikase dhe sa më profesionale, theksoi deputeti Sami Kurteshi.

Arben Gashi tha se sa i përket kërkesave buxhetore të institucioneve mendoj se nuk duhet të shkojnë në Komisionin për Buxhet si rekomandim, por duhet të shndërrohen në amendamente të Komisionit për Legjislacion në Projekt-Buxhetin e vitit 2018.

Hajdar Beqa tha se përkrahë propozimin që këto kërkesa të shndërrohen në amendamente, por para se të procedohen amendamentet të shikohet buxheti në mënyrë që të sigurohemi se a janë të përfshira në buxhet kërkesat e këtyre institucioneve në mënyrë që të mos ketë nevojë edhe nga ana jonë të procedohen përsëri. Ndërsa sa i përket KQZ-se z. Beqa tha se kërkesat e tyre për nivelim pagash kanë të bëjnë me zyrtarët e administratës, e jo të emëruarit politik, më tej shtoi duke thënë që kjo na bën më të lehtë edhe përkrahjen për kërkesat që kanë.

Albulena Haxhiu-Vërejtje kishte në kërkesën e KQZ-së ku kanë kërkuar rritje të pagës, si në institucione të tjera të cekura në kërkesën që kanë bërë. Ajo tha se kërkesa është dashtë të bëhet për nivelim të pagave, e jo rritje të pagave. Deputetja Haxhiu propozoi që të bëhet një pagë për KQZ-në në mënyrë që të përjashtohen shtesat që marrin, kur dihet se këto shtesa në kohë të zgjedhjeve janë mjaft të larta.

Arben Gashi tha se sa i përket nivelit të pagave të zyrtarëve në KQZ duhet të presim ligjin për pagat në sektorin publik dhe pastaj të rregullohet edhe çështja e pagave, se sa të tentojmë të nivelojmë pagën me ligj të buxhetit kur dihet se ky problem pastaj mund të përsëritet çdo vit, theksoi deputeti Arben Gashi.

Shkumbin Demaliaj- Meqenëse grupi punues ka sjellë rekomandimin para komisionit, ai tha se përkrahë propozimin që ky rekomandim të shndërrohet në amendamente, që pastaj të procedohen në Komisionin për Buxhet. Duke ditur që këto kërkesa kanë ardhur nga

institucionet që bien në fushëveprim të komisionit besoj që të gjithë njëzëri duhet t'i përkrahim, mirëpo kërkesat duhet të jenë specifike në mënyrë që edhe puna të jetë sa më profesionale.

Bilall Sherifi tha se nuk mendoj që të gjitha këto kërkesa do të hasin në përkrahje kur dihet se edhe nuk ka kohë të mjaftueshme që të gjitha këto kërkesa të adresohen tani. Prandaj mendoj se duhet të ndalemi në disa kërkesa ku është kërkuar buxhet shtesë, pastaj të bëhen amendamente në emër të komisionit dhe të procedohen në Komisionin për Buxhet dhe Financa për përkrahje.

Pas diskutimeve, kryesuesja konstatoi se komisioni në mënyre unanime nxori këtë:

R e k o m a n d i m

- I. Miratohen amendamentet e Komisionit të propozuara në Projektligjin nr.06/L-002 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018;*
- II. Amendamentet procedohen në Komisionin për Buxhet dhe Financa.*

Aneks të këtij procesverbali janë të bashkëngjitura amendamentet e miratuara.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Albulena Haxhiu tha se kishte vërejtjet e saj për këtë projektligj, me theks të veçantë në pikën ku ligji nuk e ndalon që një zyrtar i lartë të ketë më shumë se një vend pune. Vërejtje tjetër ishte edhe parashkrimi dhe disa terme të cilat janë përdorur në këtë ligj dhe që duhet të adresohen gjatë punës në grup punues.

Hajdar Beqa tha se të gjithë kemi vërejte dhe rekomandime rreth këtij projektligji, por megjithatë konsideroj që projektligji të kalohet në parim dhe pastaj gjatë punës në grup punues të japim kontributin si deputetë.

Arben Gashi tha se ky ligj që shtatë vjet ka hyrë në procedurë për amendamentim, ligj i cili më së shumti ka kaluar nëpër grupe punuese, ligj që vazhdimisht është kërkuar plotësim ndryshim, por meqenëse është në parim, mendoj se duhet të përkrahet në këtë fazë, pastaj të angazhohemi gjatë grupit punues.

Sami Kurteshi tha se ka vërejtje për këtë projektligj, sidomos kur bëhet fjalë për parashkrimin, pastaj vërejtje kishte në sanksionet për ata që bëjnë shkelje dhe disa vërejtje tjera, ku deputeti Sami Kurteshi tha se do t'ia paraqesë grupit punues gjatë punës në projektligj.

Glauk Konjufca tha se problemi është se zyrtarët e lartë nuk po e marrin seriozisht konfliktin e interesit, mos deklarimi në fillim i konfliktit të interesit është vepër penale dhe duhet të specifikohet edhe me këtë ligj, theksoi deputeti Glauk Konjufca.

Korab Sejdiu tha se si komision dhe Kuvend duhet të sigurohemi se sa po zbatohen rregullat dhe mekanizmat që janë të përcaktuara me ligjin për Konfliktin e Interesit dhe sa ka ndëshkime

dhe dënime për ata të cilët nuk i zbatojnë këto rregulla të përcaktuara, përndryshe është e kotë të merremi me këtë ligj ose edhe me ligje të ngjashme, tha në fund deputeti Korab Sejdiu.

Pas diskutimeve, kryetarja Konstatoi se me 7 (shtatë) vota për dhe 1 (një) abstenim vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë;

R e k o m a n d i m

Të miratohet, në parim, Projektligji nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

5. Shqyrtimi në parim i Projekt-Kodit të Drejtësisë për të Mitur

Albulena Haxhiu tha se ky projekt kod është shumë i rëndësishëm, është i njëjti nga legjislatura e kaluar edhe pse ka nevojë për disa ndërhyrje gjuhësore. Deputetja Haxhiu gjithashtu u deklarua se në parim e përkrah Projekt -Kodin e Drejtësisë për të Mitur.

Korab Sejdiu në fjalën e tij lidhur me Projekt-Kodin e Drejtësisë për të Mitur dha sugjerim se nëse është mundësia që përveç komenteve nga shoqëria civile apo oda e avokatëve të kemi edhe ndihmën e ekspertëve të cilët merren me çështje penale të të miturve, kur dihet se ky ligj mbulon një sektor shumë të veçantë të shoqërisë sonë.

Arben Gashi deklaroi se në parim përkrahë këtë projekt kod, duke ditur se sa e ndjeshme është kjo çështje dhe se duhet kujdes që të ndërtohet një model sa më i mirë. Këtu përmendi vendet nordike për modelin mjaft të suksesshëm në këtë fushë, pastaj UNICEF-in si bartës ndërkombëtar i të drejtave të fëmijëve, ku sugjeroi se duhet të kërkohet ndihma e tyre për këtë çështje dhe gjithashtu ekspertiza vendore në mënyrë që të bëhet një punë sa më e mirë rreth këtij projekt-kodi.

Igor Simiq - Tha dy gjëra që janë mjaft të rëndësishme në këtë projektligj janë masat diversive, përkatësisht masa të cilat mundësojnë që të miturit të mos kalojnë në gjithë procesin e procedurës penale për disa vepra me të lehta, por se atyre u mundësohet që përmes masave të caktuara edukative të përmirësojnë sjelljet e tyre, dhe në këtë mënyrë ata nuk marginalizohen sa i përket disa dënimeve të caktuara. Ajo që duhet në mënyrë të veçantë të theksohet, e që i mungon këtij projektligji, ka të bëjë me gjithë ata persona që marrin pjesë në mbrojtjen e të miturve, dhe të cilët duhet të kenë përgatitje / njohuri në lidhje me të drejtat e fëmijëve, dhe atë jo përmes prononcimit të tyre se kanë njohuri, por përmes certifikimit, që paraqet një lloj garantimi se ata me të vërtetë kanë njohuri adekuate për ta kryer atë punë. Po ashtu, një tjetër gjë që i mungon këtij projektligji është definimi i bashkëpunimit me organizatat qeveritare dhe jo-qeveritare, Ministria e Drejtësisë duhet të ketë marrëveshje të nënshkruara me institucione dhe shoqata ku një i mitur mund të punojë, një formulim i tillë mungon në projektligj theksoi deputeti Simiq. Duke pasur një përvojë shtatëvjeçare me të miturit z. Simiq potencoi se askush

nuk lind person agresiv, por që marrin shembuj jo të mirë nga rrethi ku jetojnë apo shoqërohen, për këtë është me rëndësi që ky projektligj të definohet në atë mënyrë që t'i dalë ballë dhe t'u përgjigjet gjithë këtyre sfidave.

Sami Kurteshi tha se ky ligj është shumë i rëndësishëm dhe grupi punues duhet të ketë parasysh komentet dhe udhëzimet nga ekspertet e vendeve nordike dhe shteteve evropiane, të cilat janë të përparuar në këtë drejtim, pra me drejtësinë për të mitur.

Hajdar Beqa tha se duke ditur rëndësinë që ka ky ligj pajtohem që përveç komisionit të merren këshilla edhe nga aktorët e tjerë të cilët merren me këtë çështje në mënyrë që të bëhet një punë sa më profesionale. Ai gjithashtu theksoi se si deputet duhet përkrahur në parim ky projekt kod dhe pastaj kontributi të jepet gjatë punës në grup punues.

Pas diskutimeve kryetarja konstatoi se komisioni në mënyrë unanime vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet, në parim, Projekt-Kodi i Drejtësisë për të Mitur

6. Shqyrtimi i kërkesës së Shoqatës së Mullisëve të Kosovës (SHMK)

Kryetarja paraqiti para komisionit kërkesën e Shoqatës së Mullisëve të Kosovës, dhe kërkoi që anëtarët e komisionit të deklarohen në lidhje me këtë çështje.

Pas diskutimeve njëzëri u vendos si vijon:

Komisioni vlerësoi se kjo çështje nuk bie në fushëveprim të Komisionit dhe vendosi që të njëjtën t'ia procedojë Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal.

Anëtarët e Komisionit paraqiten shqetësimet e tyre, në lidhje me shkresën e Shoqatës së Mullisëve të Kosovës dhe ankesat e tyre në lidhje me mënyrën e trajtimit të TVSH-së gjatë përpunimit të grurit të fermerëve (UJEMI). Në lidhje me këtë, Komisioni vendosi që t'i rekomandojë Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal që të shqyrtojnë këtë shkresë.

7. Formimi i grupeve punuese për Projektligjin nr. 06/L-010 për Noterinë, Projektligjin nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-007 për procedurën jokontestimore, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/26 për Trashëgiminë në Kosovë, dhe Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës

Pas diskutimeve Komisioni, nxori këtë:

V e n d i m

Për formimin e grupeve punuese për Projektligjin nr. 06/L-010 për Noterinë, Projektligjin nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-007 për procedurën jokontestimore, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/26 për Trashëgiminë në Kosovë, dhe Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës

1. Formohet Grupi i punës për Projektligjin nr. 06/L-010 për Noterinë, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/26 për Trashëgiminë në Kosovë me këtë përbërje:

1. Albulena Haxhiu-kryetare,
2. Hajdar Beqa-anëtar,
3. Sami Kurteshi-anëtar,
4. Igor Simiq-anëtar,
5. Korab Sejdiu-anëtar,
6. Bahrim Shabanaj-anëtar.

2. Formohet grupi punues për Projektligjin nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim me këtë përbërje:

1. Arben Gashi-kryetar,
2. Hajdar Beqa-anëtar,
3. Albulena Haxhiu-anëtare.

8. Të ndryshme

Në këtë pikë të rendit të ditës deputeti Hajdar Beqa njoftoi anëtarët e komisionit rreth punëtorisë për Rregulloren e Kuvendit, e cila është paraparë të mbahet më 18-20 dhjetor në Tiranë, gjithashtu deputetja Albulena Haxhiu njoftoi anëtarët e komisionit për vizitën që ajo ka paraparë të bëjë në burgun e Dubravës, ku ftoi anëtarët që nëse kanë gatishmëri të bashkëngjiten në këtë vizitë.

Mbledhja përfundoi në orën 15:10.

E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu

Aneks. Amendamentet e Komisionit të propozuara në Projektligjin nr. 06/L-002 për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Amendamenti 1

Të ndahen mjete shtesë për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas, me kod organizativ 241 dhe me kod të programit (nën programit) 32600 në shumë totale 53,100 €, në kuadër të kategorisë Paga dhe Mëditje 22,280 € për katër zyrtar të Agjencisë dhe në kuadër të kategorisë Mallra dhe Shërbime 30,820 €.

Amendamenti 2

Të ndahen mjete shtesë për Akademinë e Drejtësisë, me kod organizativ 322, si dhe me kod të programit (nën programit) 91600. Në kuadër të kategorisë Mallra dhe Shërbime të ndahen mjete shtesë në shumë 301,740 €, për trajnime fillestare për prokurorë dhe gjyqtar. Gjithashtu të ndahen mjete shtesë me shumë 8,820 në programin e njëjtë në kategorinë Mallra dhe Shërbime për mësimin në distancë. Po ashtu kërkohet ndarjen e mjeteve shtesë për 7 pozita për burime njerëzore të Akademisë së Drejtësisë në kategorinë Paga dhe Mëditje me shumë 37,800 €.

Amendamenti 3

Të ndahen mjete shtesë për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, me kod organizativ 329 si dhe me kod të programit (nën programit) 60600. Në kategorinë e Pagave dhe Mëditje me shumë 298,000 € si dhe të rritet numri i punonjësve për 20 pozita pune. Nga shuma 298,000 €, 98,000 € do të përdoren për pagesë për pagat e 20 zyrtarëve, ndërsa 200,000 € do të përdoren për shtesa të zyrtarëve në emër të rrezikshmërisë. Të ndahen mjete shtesë me shumë prej 88,000 € në kategorinë e Investimeve Kapitale për blerjen e 3 veturave. Gjithashtu të ndahen mjete shtesë në kategorinë e shpenzimeve komunale me shumë 88,523 €.

Amendamenti 4

Të ndahen mjete shtesë për Këshillin Prokurorial të Kosovës, me kod organizativ 250 si dhe me kod të programit (nën programit) 33500 prokurorët dhe administrata. Në kuadër të kategorisë Paga dhe Mëditje si edhe në emër të shtesave kujdestarive me shumë 1,285.101.12 €, Në kuadër të kategorisë Mallra dhe Shërbime shuma e nevojshme është 714,000 €.

Amendamenti 5

Të ndahen mjete shtesë për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, me kod organizativ 328 si dhe me kod të programit (nën programit) 33300 Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës me shumën totale 722,568.6 në këto kategori ekonomike: Në kuadër të kategorisë paga dhe mëditje me shumë 390,568.60 €, në kuadër të kategorisë Mallra dhe Shërbime shumë 82,000 €, në kuadër të kategorisë Subvencione dhe Transfere (kompensim të dënuarve pa bazë) me shumë 150,000 €

dhe në kategorinë Shpenzime Kapitale 100,000 € për implementimin e projektit Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve.

Amendamenti 6

Të ndahen mjete shtesë për Agjencinë Kundër Korrupsion, me kod organizativ 236 në kuadër të programit (nën programit) 20400 në shumën totale 83,000.00 €. Në kuadër të kategorisë Paga dhe Mëditje me shumë 53,000.00 € për (6) gjashtë zyrtarë dhe në kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime me shumë 30,000.00 €.

Amendamenti 7

Të ndahen mjete shtesë për Komisionin Qendror Zgjedhorë, me kod organizativ 320 në kuadër të programit (nën programit) 14100 Sekretariati, në shumën totale 490,701 €. Në kuadër të kategorisë Paga dhe Mëditje me shumë 410,180 € ndërsa në kuadër të kategorisë Mallra dhe Shërbime me shumë 80,521 €.

